

**Vasillaq Kolevica  
ka lindur në Korçë,  
më 17 prill 1959.**


**Që në moshë të  
vogël, arti ishte  
pjesë e pandashme  
e jetës familjare,  
babai Dhimitraq  
Kolevica  
pikturonte bashkë,  
ndërsa e ëma nën  
tingujt e pianos i  
solli pasionin për  
melodinë.**

**Në vitet 1974-1978,  
Vasi ndoqi Liceun  
Artistik të Korçës,  
ku realizoi edhe  
veprën e tij të parë,  
të vajzës që  
dashuronte,  
Andonetës, e cila  
ishte në moshën 15-  
vjeçare, sot është  
gruaja e tij.**

**Përfundoi studimin  
në Universitetin e  
Arteve në Tiranë  
(2008-2012).**

**PORTFOLIO**

**V. Kolevica**



**"Njëndizaj në qoshen  
jam penguar  
Dhe ah! e theva Poçen e  
bekuar;  
Më tha: "Si je, kam qenë;  
dhe si jam,  
Ashtu dhe ti je nesër i  
dërmuar".**

**- Omar Khayyam.**

**Rrëmuar nga filozofia e  
Omar Khayamit, i cili i  
jep zë baltës përmes  
vargjeve të tij, kujtojmë  
krijuesin se gjithçka e  
formuar nga duart e  
njeriut mban kujtesën e  
asaj që ka qenë dhe do  
të bëhet.**

**Vasillaq  
Kolevica**

# Përmbajtje

RRETH VASIT

HISTORIA E STUDIOS

FILOZOFIA ARTISTIKE

PROFILI & EKSPERIENCA



PANAIRE & ÇMIME




NGJARJET E VASIT

BALTA KA KUJTESË

GALERIA


KONTAKT

FALEMINDERIT



*Mirë se erdhe në Prugëtimin e Vasit*





## Rreth Vasis

Vasillaq Kolevica ka lindur në Korçë, më 17 prill 1959, në një familje me trashëgimi artistike dhe origjinë të largët greke.

Në vitet 1974-1978, Vasi ndoqi Liceun Artistik të Korçës. Për shkak të biografisë familjare, iu mohua e drejta për të ndjekur Universitetin e Arteve, por u rikthye më vonë për ta përfunduar studimin në Universitetin e Arteve në Tiranë (2008-2012).

Studioja e parë lindi në fund të viteve '70, në Pazarin e Vjetër të Korçës, ku artisti ndërtoi vetë furrat dhe tornot e para për punimin e qeramikës.

Çdo objekt i krijuar nga duart e tij mbart një copëz identiteti, të punuar me përkushtim, të menduar me ndjesi dhe të realizuar me intuicion emocional që tejkalon funksionin estetik.



### ***Seria "Poçari"***

Rrëmuar nga filozofia e Omar Khayamit, fragmentet dhe enët e vogla rikrijnë këtë dialog të përjetshëm midis duarve që krijojnë dhe materies që kujton, një meditacion mbi brishtësinë, rilindjen dhe kujtesën e përjetshme të tokës dhe shpirtit.



# Historia e Studios

## *Historia e plotë*

Kolevica Art është më shumë se një hapësirë krijuese, është një vend ku argjila frymon, dhe ku arti dhe dashuria për formën shndërrohen në një gjuhë të përbashkët.

Brenda saj ndjehet ngrohtësia e tokës, aroma e qeramikës dhe drita që lind nga duart e artistëve.

Kolevica Art Studio është themeluar nga artisti Vasillaq Kolevica, si një hapësirë e përkushtuar ndaj skulpturës dhe qeramikës artistike. Me rrënjë të thella në qytetin e Korçës, studioja mishëron traditën, mjeshtërinë dhe frymën bashkëkohore në çdo vepër.

Studioja e parë lindi në fund të viteve '70, në Pazarin e Vjetër të Korçës, ku artisti ndërtoi vetë furrat dhe tornot e para për punimin e qeramikës.

Pas viteve '90, me ndryshimin e sistemit, studioja u zhvendos në shtëpi dhe më pas, në vitin 1994, mori formën e plotë si Kolevica Art Studio, që sot bashkon traditën, dhe filozofinë e artit të qëndrueshëm.

Çdo objekt i krijuar këtu mbart një copëz identiteti, të punuar me përkushtim, të menduar me ndjesi dhe të realizuar me intuicion emocional që tejkalon funksionin estetik.

Familja Kolevica ka rrënjë të thella artistike dhe intelektuale.

Nëna e Vazit ishte pianiste e Liceut Francez, ndërsa babai luante violinë, kitarë dhe benxho, duke i përcjellë dashurinë për muzikën dhe artin.

Sot, fryma krijuese vazhdon përmes vajzave të tij, të cilat kanë zgjedhur rrugën e arteve dhe arkitekturës, duke ruajtur trashëgiminë e familjes. Veçanërisht, Anjeza Kolevica, vajza e vogël e Vasit, ka ndjekur rrugën e të atit duke e zgjeruar vizionin e tij artistik me ndjeshmëri bashkëkohore.



#### NGA VASI, NË ANJEZA.

Pjesë e pandashme e këtij universi krijues është edhe Andoneta, bashkëshortja e Vasit, e cila i jep ngjyra, dhe jetë çdo vepre që lind nga duart e tyre.

Në duart e Vasit dhe Anjezës, çdo pjesë balte bëhet një historie më e madhe.

Qeramika gjallërohet, duke reflektuar filozofinë e riciklimit dhe qëndrueshmërisë, sepse arti këtu nuk shpenzon, por rigjeneron. Ai rikthen jetën në çdo detaj, në çdo ngjyrë që shndrit nën dritën e diellit.

Për Vasin dhe Anjezën, arti i poçerisë është një mënyrë për të ndërtuar botën me dashuri dhe përgjegjësi.



Në punishten e tyre, çdo objekt është vazhdim i shpirtit, një bashkim mes funksionales dhe poetikes. Të punosh me argjilën, për ta, do të thotë të dialogosh me kohën, me rrënjët dhe me të ardhmen njëkohësisht.

Në çdo projekt, Vasi dhe Anjeza përfshihen familjarisht, së bashku me Andonetën, dhe kanë ndërtuar një laborator të mirëfilltë arti, nga ku konceptojnë idenë në letër, i japin formë baltës, e pjekin, dhe në fund i japin identitet.

Ata besojnë se zhvillimi qëndron te bashkëpunimi, jo te importi, dhe se arti duhet të mbetet një akt i gjallë, njerëzor dhe i papërsëritshëm. Në thelb, Kolevica Art Studio është ndërthurje e artit me jetën, e shpirtit me strukturën, e idesë me materien.

Një dëshmi që arti, si dashuria, mund të realizohet me duar, me zemër dhe me identitet.



## Vepra e parë

Vepra e parë i përket vajzës që ai dashuronte, dhe që ende e do, Andonetës, atëherë vetëm 15 vjeç, e sot bashkëshortja e tij.

Ishte viti 1974, në Korçën e bukur, kur Vasi ndiqte Liceun Artistik. Aty e frymëzonte shoqja e tij e ngushtë, pa e ditur asnjëri prej tyre se ajo do të bëhej shoqja e jetës së tij.

Një lidhje që me kohën do të bëhej nyje e rrugëtimit të tij më të thellë, jo vetëm sepse sot ndajnë së bashku dashurinë për dy vajzat e tyre, Anxhelikën dhe Anjezën, por edhe sepse Andoneta ka qenë dhe mbetet pjesë e pandarë e udhës krijuese të Vasi Kolevicës.

Në çdo hap të saj, që nga ditët e Liceut e deri te ndërtimi i studios së tij, ajo ka qenë aty, frymëzim, mbështetje dhe dëshmi e një jete që ka marrë formë përmes artit dhe dashurisë.

# Këndvështrime të Vasisit



**Modelimi:** Mikel Temo  
**Realizimi në qeramike:** Vasillaq Kolevica



# Filozofia Artistike

Për Vasillaq Kolevicën, arti lind aty ku drita prek materien dhe heshtja merr frymë.



Balta për të nuk është thjesht material, por kujtesë, ajo ruan emocionin, përlësinë dhe dashurinë e njeriut që e prek.

Në çdo vepër, ai kërkon lidhjen mes njeriut dhe tokës, mes kujtimit dhe formës.

Skulptura është mënyra e tij për të folur me botën, për ta rigjallëruar atë përmes gjurmës njerëzore.

Arti i Kolevicës nuk synon përsosmëri, por ndjesi. Ai rigjeneron, rikujton, dhe kthen çdo fragment në dëshmi dashurie. Sepse në fund, për të, të bësh art do të thotë të jetosh me kujtesë, dhe ta kthesh jetën në formë.

Ashtu si muzika që buron nga heshtja për të krijuar melodi, edhe arti i tij lind nga qetësia për të folur me ndjenjë. Në të dyja, ai gjen ritmin e shpirtit dhe harmoninë e kujtesës.



*pak kujtesë*



# Profili & Eksperienca



## Edukimi

- Liceu Artistik i Korçës (1974-1978)
- Universiteti i Arteve, Tiranë (2008-2012)

## Përvoja Artistike

- Aktiv në skenën artistike që nga viti 1978
- Themelues i Kolevica Art Studio, Korçë (1994-sot)
- Pjesëmarrës dhe fitues në ekspozita kombëtare dhe ndërkombëtare në Shqipëri, Greqi, Itali, dhe Maqedoni
- Autor i një game të gjerë veprash në qeramikë, skulpturë dhe relief
- Frymëzuar nga filozofia e materies dhe kujtesës njerëzore, ku arti merr formë si identitet
- Drejtor i Monumenteve të Qarkut të Korçës (2012-2013)

## Ekspozita Kryesore

- 7 Ekspozita personale në Korçë
- 4 Ekspozita personale në Tiranë
- 4 Ekspozita ndërkombëtare (Itali & Greqi)
- Ekspozitë personale në Galerinë Kombëtare të Arteve, Tiranë (2007)
- ▪ Dhurim i veprës "Kryqëzim" në fondin e përhershëm të GKA
- Ekspozita ndërbalkanike e artit kishtar, Volos - Greqi
- Simpozium Ndërkombëtar i Skulpturës, Korçë (2010, 2024)

## Vepra në Hapësira Publike

- Monument guri "Kompleksi i Mitingut të Shkronjave" - Kisha "Shën Dellia", Korçë
- Basorelief në hollin e Qarkut Korçë
- Basorelieve masive në Fabrikën e Birrës Korçë
- 5 vepra në fondin e Galerisë së Arteve, Korçë.

## Gjuhë të Huaja

- Italisht
- Greqisht

## Drejtor i Monumenteve të Qarkut te Korçës (2012-2013)



Kisha e Kryeëngjellit Shën Mëhill dhe  
Gabrielit Voskopoje



Shën Pjetër Vithkuq



Shën Maria Vithkuq



Shën Ilia Voksopojë



Shën Triadha Tudas Lekas



-Shën Maria Voskopojë




# *Çmime, Ekspozita, nderësime*





# **Çmime Ekspozita Vlerësime**



## Çmime

1983-1986

• Fitues i Çmimit të Parë dhe të Dytë në konkurset e Arteve të Aplikuara - Çmimet e Rinisë Artistike.

1990

• Medalja "Naim Frashëri" - Akorduar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPSSH, për vepra me nivel të lartë artistik në qeramikë.

2005

• Çmimi i Dytë në Skulpturë - Konkursi Kombëtar "Vangjush Mio", Galeria "Guri Madhi", Korçë.

2006

• Çmimi i Parë në Skulpturë - Konkursi Kombëtar "Vangjush Mio", Galeria "Guri Madhi", Korçë.

2008

• Çmimi "Odise Paskali" - Boboshticë, për krijimtari të spikatur dhe pjesëmarrje të suksesshme në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare.

2016

• Çmimi "Më i Miri në Vend" - për promovimin e qeramikës tradicionale dhe moderne shqiptare.

## Ekspozita & Pjesëmarrje Ndërkombëtare

2007

• Ekspozitë Personale - Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë

▪ Dhurim i veprës "Kryqëzim" në fondin e përhershëm të GKA

• Ekspozitë Qeramike - Argos Orestiko, Kastoria (Greqi), nën kujdesin e Ministrisë së Maqedonisë dhe Trakës

• Ekspozitë Ndërballkanike - "Neanthropismos kai Valkanion", Volos (Greqi), Mirënjohje nga Mitropolia e Dimitriadës

2009

• Ekspozita Kombëtare "Vangjush Mio" - Korçë, Certifikatë Pjesëmarrjeje nga Bashkia Korçë

2010

• Simpoziumi Ndërkombëtar i Skulpturës - Korçë, ftesë zyrtare nga Bashkia Korçë (Niko Peleshi)

2024

• Korça International Art Symposium, XIV Edition - "The Days of Vangjush Mio", nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, Sotiraq Filo



## Tituj & Vlerësime

2019

- Titulli "World AS Sculptor"  
- Akorduar nga The World Peace Committee, Jakarta
- Titulli "Mjeshtër"  
Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, Nr. regjistri 146 (17.10.2019).

2020

- Titulli "Mjeshtër i Madh" - Akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, për kontribut të jashtëzakonshëm në artin figurativ dhe trashëgiminë qeramike kombëtare.



# Ngjarjet e Vasit

# Ngjarjet e Vasit



## “Teto Ollga”, rikthehet përgjithmonë në Tushemisht, Ora News, 2013

Shtatorja u punua nga skulptorët **Vasillaq Kolevica** dhe Sadik Spahia, të cilët kanë përshëndetur idenë e kreut të kësaj komune, Roshi Tollozhina për ndërtimin e kësaj vepre arti që përcjellë portretin e një artisteje të talenuar dhe të dashur për publikun shqiptar.

[CLICK HERE](#)

## Të mbajmë gjallë artin e qeramikës | Vasillaq Kolevica | TEDxTirana, 2015

Kolevica nis me një vështrim personal: si nga fëmijëria në Korçë, tanimë qytet me traditë qeramike, ai u përfshi në artin e argjilës. Ai përshkruan qeramikën jo vetëm si material, por si kujtesë, si lidhje e njeriut me tokën, me rrënjët e tij, me formën që merr jeta.

[CLICK HERE](#)



## Korçë, artisti i qeramikës Vasillaq Kolevica sfidë me teknologjinë, Report TV, 2018

Kolevica shpjegon procesin e krijimit: nga formimi i vazës, pjekja zgjat më shumë se dy ditë, ndërsa vendosja e ngjyrave gjithashtu kërkon shumë kohë. Kolevica shpreh keqardhje që arti i qeramikës po humbet me brezat e rinj dhe i bën thirrje të rinjve që të marrin pjesë: ta vazhdojnë zanatin dhe ta ruajnë këtë trashëgimi.

[CLICK HERE](#)

# Ngjarjet e Vasit

## Artisti Vasillaq Kolevica merr titullin "Mjeshtër", RTSH KORCA, 2020

Kolevica merr titullin "Mjeshtër" nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë për përvojën e tij shumëvjeçare, njohuritë profesionale në qeramikë, dhe përcjelljen e zanatit tek të rinjtë. Ai ka mbajtur gjallë traditën e qeramikës për dekada, edhe vazhdon.

[CLICK HERE](#)



## "Vrit babain, siç bëra unë", amaneti artistik që Kolevica i jep te bijës në ekspozitën e parë

Vasillaq Kolevica ose i fundit i moikanëve siç e thërrasin në qytetin e Korçës. Di të flasë për baltën si të ishte frymor, duke bërë bashkë të pasurin e të varfrin, pluhuri i të cilëve në duart e poçarit është njësoj. Edhe pse prej 50 vjetësh ai krijon duke i dhënë jetë baltës, duke trashëguar artin e babait deri diku i detyruar në atë kohë por sot mirënjohës.


[CLICK HERE](#)

## Arti i Poçarisë/ Vasillaq Kolevica, "poçari i fundit" që baltën e ka kthyer në art, RTSH Korca, 2024

Kolevica është një mjeshtër i qeramikës (poçari). Sipas tij, balta "rrjedh në venat" e tij, që pasqyron lidhjen e thellë personale me këtë material. Studioja e tij, Kolevica Art, është një hapësirë ku trashëgimia tradicionale e poçarisë bashkohet me artin bashkëkohor.

[CLICK HERE](#)





# HOMO FABER

QERAMIST | DRENOVË, SHQIPËRI

Vasillaq ka rreth pesë dekada përvojë si qeramist. Ai ka galerinë më të madhe të qeramikës në Shqipëri.

Ai krijon një përzierje baltërash që i gjen në zona të ndryshme të vendit.

Me një pasion të madh për pikturën, Vasillaq Kolevica dëshironte të bëhej piktor si i ati. Por fati e lidhur me qeramikën në vitin 1974 dhe nuk u nda kurrë më prej saj.

Vasillaqi ndoqi universitetin për Skulpturë dhe Qeramikë, por mjeshtërinë e tij në qeramikë ia atribuon përvojës së përditshme në punën me baltën. Ai ka qindra vepra në punishten dhe galerinë e tij, disa prej të cilave janë mbi dy metra të larta, përfshirë skulptura, dekorime muri, vazo, pjata dekorative dhe të tjera.

Pasioni i tij për artin dhe qeramikën ishte aq i thellë sa gruaja dhe dy vajzat iu bashkuan këtij udhëtimi krijues, duke prodhuar vepra arti me një shtrirje universale. Frymëzuar nga esenca e feminitetit, ai i ka kushtuar shumë nga veprat e tij celebrimit të figurës femërore. Për të, gratë janë krijueset e jetës, dhe si të tilla, ai i paraqet si perëndesha në krijimet e veta.

Një jetë e tërë duke punuar baltën në forma, ngjyra, madhësi dhe dizajne të ndryshme flet më shumë se çdo gjë tjetër për mjeshtërinë e Vasillaqit.

[CLICK HERE](#)



# BALTA KA KUJTESË



Rrëmuar nga filozofia e Omar Khayamit, i cili i jep zë baltës përmes rubairave të tij, duke kujtuar krijuesin se gjithçka e formuar nga duart e njeriut mban kujtesën e asaj që ka qenë dhe do të bëhet.

“Njëndizaj në qoshen jam penguar  
Dhe ah! e theva Poçen e bekuar;  
Më tha: "Si je, kam qenë; dhe si jam,  
Ashtu dhe ti je nesër i dërmuar".

- Omar Khayyam.

Fragmentet dhe enët e vogla rikrijojnë këtë dialog të përjetshëm midis duarve që krijojnë dhe materies që kujton, një meditacion mbi brishtësinë, rilindjen dhe kujtesën e përjetshme të tokës dhe shpirtit.






# VASILLAQ KOLEVICA

DRENOVË, SHQIPËRI

+355 682261342

[WWW.KOLEVICA-ART.COM](http://WWW.KOLEVICA-ART.COM)



## I FALEM NDERIT!

Faleminderit që i kushtove kohën tënde për të lexuar këtë portfolio dhe për t'u njohur më nga afër me jetën, krijimtarinë dhe pasionin e mjeshtrit të qeramikës, Vasillaq Kolevica.

Vlerësimi yt ndaj artit është një motivim i madh për të vazhduar këtë udhëtim krijues që ka zgjatur një jetë të tërë.

Shpresojmë që frymëzimi, ngjyrat, format dhe historia e baltës të kenë gjetur vend në mendimet dhe emocionet e tua.

**V. KOLEVICA**

F A L E M N D E R I T